




MODELI 3D I QYTETIT TË KONISPOLIT
PËRFTUAR NGA TEKNOLOGJIA UAV

Ortofoto Satelitore 2026 – Ultësira Perëndimore

ASIG ka realizuar ortofoton satelitore të vitit 2026 për pjesën perëndimore të territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim përditësimin e të dhënave gjeohapësinore në nivel kombëtar. Ky produkt gjeohapësinor me rezolucion 50 cm ofron informacion të përditësuar dhe të besueshëm në mbështetje të planifikimit dhe menaxhimit të territorit, monitorimit të ndryshimeve në përdorimin e tokës, si dhe proceseve të vendimmarrjes së institucioneve publike. ASIG do të vijojë punën për sigurimin e mbulimit të plotë të territorit të Republikës së Shqipërisë me imazhe satelitore të përditësuara.

Imazhe satelitore – Lumi i Vjosës (1); Kepi i Lagjit, Kavajë (2); Porti i Shëngjinit (3); dhe Liqeni i Fushë-Krujës (4).




Publikime në Gjeoportalin Kombëtar

Publikohet informacion gjeohapësinor për temat “Parcelat Kadastrale” dhe “Ndërtesat”


ASIG, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), ka përditësuar shtresat për temat “Parcelat kadastrale” dhe “Ndërtesat” në Gjeoportalin Kombëtar, si më poshtë:

- Parcelat Kadastrale (ALBSCAD);
- Ndërtesa Kadastrale (ALBSCAD).

Të dhënat përfshijnë zona ose blloqe kadastrale të përpunuara në Sistemin Multifunksional nga drejtoritë vendore të ASHK-së, nëpërmjet përditësimit të transaksioneve.



Publikohet informacion gjeohapësinor për temën “Zonat e Mbrojtura”



ASIG, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), ka përditësuar shtresën “Zonat e Mbrojtura të Trashëgimisë Kulturore (poligon)” në Gjeoportalin Kombëtar, për temën “Zonat e Mbrojtura”, bazuar në:

- VKM nr. 494, datë 26.06.2026, “Për deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme të ‘Qendrës Historike’ të fshatit Dhërm”;
- VKM nr. 519, datë 30.06.2026, “Për deklarimin ‘Pasuri kulturore e paluajtshme’ të Parkut Arkeologjik Apoloni”.

Zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore përfshijnë qendrat historike, ansamblet arkitektonike urbane dhe zonat e tyre mbrojtëse, zonat arkeologjike të kategorive “A” dhe “B”, si dhe zonat mbrojtëse të monumenteve të veçanta.


Të dhënat janë në përputhje me standardin shtetëror për temën “Zonat e mbrojtura”, miratuar me VKM-në nr. 891, datë 18.11.2020.

Zgjerimi i Hartës Bazë: Zona Melgush (Qarku i Shkodrës)

ASIG, në cilësinë e autoritetit publik përgjegjës për temën “Harta Bazë” dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë në shkallën 1:2000, ka vijuar punën për krijimin e hartës topografike digjitale të zonës rurale Melgush në qarkun e Shkodrës.

Krijimi i kësaj harte është realizuar përmes teknologjisë së rilevimit fotogrametrik 3D. Procesi i rilevimit ka mbuluar një sipërfaqe prej 23 km², ndërsa numri i shtresave të përdorura për krijimin e hartës arrin në 180.

Melgush , Qarku i Shkodrës




Rilevime me teknologjinë UAV në disa zona të vendit

ASIG ka realizuar fotografimin ajror dhe përpunimin e të dhënave gjeohapësinore me teknologjinë UAV në **zonat e Hasit, Bajram Currit, Libohovës, Konispolit, Delvinës, Bulqizës** dhe **Peshkopisë**, duke mbuluar një sipërfaqe totale prej rreth 31,3 km².


Ky proces është realizuar për krijimin e ortofotove dhe modeleve 3D me rezolucion të lartë. Produktet e përfutuara ofrojnë të dhëna të përditësuara dhe të besueshme në mbështetje të planifikimit, monitorimit, analizës gjeohapësinore dhe vendimmarrjes.

Nga ky proces janë përfutur:


- ortofoto;
- modele digjitale të sipërfaqes (DSM);
- modele digjitale të terrenit (DTM);
- modele 3D të territorit;
- izoipse.



DTM dhe DSM – Has



Ortofoto dhe izoipse – Bajram Curri



Fotografimi i gjeoreferencuar 360° i rrjetit rrugor kombëtar


Për krijimin e fotografive panoramike të gjeoreferencuara të akseve rrugore kombëtare, ASIG ka përdorur teknologjinë Street View me kamera 360°. Fotografitë e realizuara dhe të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar mbulojnë:

- rrugët urbane të qyteteve të Krumës dhe Bajram Currit – 32 km;
- aksin rrugor Kukës–Novosej–Shishtavec – 28 km;
- rrugët urbane të qytetit të Libohovës – 20 km.

Ky informacion vizual i detajuar shërben si mjet mbështetës për planifikimin territorial, menaxhimin e infrastrukturës dhe monitorimin e zhvillimeve urbane.



Rrugë urbane – Bajram Curri



Rrugë urbane – Libohovë

ASIG zhvillon leksion të hapur në Akademinë e Forcave të Armatosura

Përfaqësues të ASIG zhvilluan një leksion mbi rolin dhe rëndësinë e informacionit gjeohapësinor për pjesëmarrësit në Kursin e Lartë të Oficerit dhe në Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, në kuadër të programit mësimor të Akademisë së Forcave të Armatosura.

Gjatë leksionit u trajtuan tema që lidhen me përdorimin e informacionit gjeohapësinor në mbështetje të planifikimit, vendimmarrjes dhe mbrojtjes, si dhe me rolin e tij në përmbushjen e nevojave strategjike dhe operacionale.

Ky aktivitet kontribuoi në zgjerimin e njohurive të oficerëve pjesëmarrës mbi teknologjitë dhe të dhënat gjeohapësinore, si dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional në fusha me rëndësi strategjike.



BOTA E GJEONFORMACIONIT

OGC teston standarde të reja për shkëmbimin e të dhënave detare

Open Geospatial Consortium (OGC) ka nisur fazën e gjashtë të projektit pilot për Infrastruktura e Federuar të të Dhënave Hapësinore Detare (FMSDI), me qëllim përmirësimin e shkëmbimit të informacionit përmes standardeve të hapura. Nisma teston ndërveprueshmërinë e të dhënave dhe metadatave, aksesin e sigurt ndërinstytucional dhe lidhjen ndërmjet informacionit tokësor dhe detar. Për vende bregdetare, këto praktika mund të mbështesin planifikimin hapësinor detar, monitorimin mjedisor, lundrimin dhe menaxhimin e emergjencave.

Copernicus Marine prezanton platformën MyOcean Health për monitorimin e shëndetit të oqeanëve

Shërbimi Detar Copernicus ka vënë në dispozicion MyOcean Health, një platformë digjitale falas që shndërron mbi tri dekada të dhënash oqeanike në tregues të qartë dhe ndërveprues. Platforma ofron harta, grafikë dhe të dhëna pothuajse në kohë reale për temperaturën e sipërfaqes së detit, valët e të nxehtit detar, nivelin e detit, acidifikimin e oqeanëve dhe shtrirjen e akullit detar. Përdoruesit mund të shohin edhe parashikime dhjetëditore për tregues të caktuar, në mbështetje të kërkimit shkencor, planifikimit mjedisor dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

AKTIVITETE NË VIJIM

State of the Map 2026

Nga 28–30 gusht 2026, në Paris, të Francës, do të zhvillohet konferenca vjetore ndërkombëtare e komunitetit OpenStreetMap. Aktiviteti do të mbledhë hartografë, zhvillues dhe profesionistë të fushës për të diskutuar zhvillimet më të fundit në cilësinë e të dhënave hartografike, aplikimet e OpenStreetMap teknologjitë gjeohapësinore dhe inovacionet që mbështesin përdorimin e të dhënave të hapura gjeohapësinore.

28–30 gusht 2026

INTERGEO 2026

Nga 15–17 shtator 2026, në Mynih të Gjermanisë, do të zhvillohet INTERGEO Munich 2026, panairi dhe konferenca më e rëndësishme evropiane në fushën e gjeoinformacionit. Aktiviteti do të mbledhë kompani, institucione kërkimore, organizata publike dhe profesionistë të sektorit gjeohapësinor për të prezantuar risitë më të fundit në GIS, dronë, qytete inteligjente, matje topografike dhe transformim digjital.

15–17 shtator 2026

QGIS User Conference 2026

Më 5–6 tetor 2026, në Laax, të Zvicrës, do të zhvillohet QGIS User Conference, konferenca e përdoruesve dhe zhvilluesve të softuerit QGIS me burim të hapur. Aktiviteti ofron një platformë për prezantimin e zhvillimeve më të fundit të QGIS, shkëmbimin e përvojave praktike dhe forcimin e rrjetit profesional ndërmjet pjesëmarrësve nga industria, akademia dhe komuniteti global i teknologjive gjeohapësinore.

5–6 tetor 2026

www.asig.gov.al

www.geoportal.asig.gov.al

Rruga e Dibrës (pranë Ministrisë së Mbrojtjes), Tiranë;

Telefon: +355 (0)42 223 762;

E-mail: info@asig.gov.al